



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.52/2017

Prishtinë, më 27 mars 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Kujtim Paqaku.

Mungoi: Shukrije Bytyçi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Fehmi Hyseni-Drejtor i Drejtorisë për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare, Kuvendi i Kosovës, Taulant Osmani-Kallxo.com, Edona Kurteshi-Koha Ditore, Nehat Dervishi-OSBE dhe Florije Kryeziu-UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit.

Andaj, Komisioni i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

- 1. Shqyrtimi i Vendimit të Avokatit të Popullit për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit;**
- 2. Shqyrtimi i Peticioneve;**
- 3. Të ndryshme.**

1.Shqyrtimi i Vendimit të Avokatit të Popullit për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e 5 zëvendësve të Avokatit të Popullit

Kryetarja tha se edhe në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës, ndërsa sot kemi pritur një këshillë juridike, në formë të shkruar, nga drejtoria Ligjore e Kuvendit. Megjithatë, një këshillë e tillë nuk ka ardhur, andaj Komisionit i mbetet që sot të marrim vendim për këtë. Vërejtja, siç e dini, ekziston te procedimi i kandidatit nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se e kam analizuar ligjin. Meqenëse thuhet se për pozitën e zëvendësve të avokatit nga radhët e minoriteteve dhe për pozitën e zëvendësve të avokatit nga gjinia e kundërt nga ajo e avokatit, thuhet se votimi bëhet i ndarë. Pra, është mirë avokati me dhënë alternativa se si të bëhet votimi ndaras ose të shkohet me këtë propozim, që për pozitën e minoriteteve të shpallet konkurs prapë dhe të plotësohen kriteret ligjore.

Ajo theksoi se ndoshta është mirë të kërkojmë edhe një herë mendimin e Avokatit të Popullit, pse nuk është bërë ndarja për votim ashtu siç ceket me rregullore.

Teuta Haxhiu pyeti se nëse për komunitetin jo shumicë shkohet prapë me konkurs, dhe në listë mbesin 9 kandidatë dhe pastaj nëse vendosen edhe dy kandidatë prej minoriteteve në listë bëhen 11 kandidatë, a është cenim kjo?

Ajo theksoi se është e mendimit që të procedohet lista ashtu siç ka ardhur nga Institucioni i Avokatit të Popullit, dhe seanca të vendosë.

Nga administrata e Kuvendit u bë e ditur se nuk ka cenim, sepse në ligj thuhet se së paku për një pozitë të zëvendës avokatit, duhet të jenë të propozuar dy kandidatë, që nënkupton se munden me qenë më shumë se dy.

Mytaher Haskuka theksoi se Avokati i Popullit e ka mbrojtur parimin se ka vepruar sipas ligjit, ndërsa lidhur me votimin e ndarë u interesua të dijë se a parashihet me ligj apo me anë të rregullores.

Ai theksoi se duhet të procedohet lista ashtu siç është dhe nëse nuk zgjidhet kandidati për minoritete dhe për gjininë femërore atëherë le të shkohet me shpallje të konkursit.

Salihe Mustafa tha se pavarësisht a duhet të procedohet me lista të ndara apo jo, thuhet qartë që për një pozitë duhet me qenë të propozuar dy kandidatë, gjë që sa i përket kandidatit nga komunitetet jo shumicë na imponohet që të zgjedhim vetëm atë që është në listë, sepse nuk kemi mundësi tjetër. Për këtë duhet të kthehet propozimi dhe të procedohet sipas rregullores.

Nenad Rashiq tha se procedimi i listës si është, nuk ka kuptim sepse nuk është sipas rregullave procedurale. Avokati i Popullit nuk ka përgatitur listën siç duhet dhe ne po mendojmë të gjejmë atë zgjidhje që shkakton dëmin më të vogël.

Etem Arifi pyeti se a kemi të drejtë që propozimin me e kthye te propozuesi në mënyrë që të procedojë në përputhje me ligjin dhe rregullat procedurale.

Drejtoria ligjore tha se propozimin duhet ta kthejë seanca nëse këtë e rekomandon komisioni.

Lirije Kajtazi tha se si komision i rekomandojmë seancës plenare që kjo listë t'i kthehet Avokatit të Popullit, në mënyrë që të procedohet në përputhje të plotë me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe me Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Kryetarja hodhi në votim propozimin e lartpërmendur.

Kryetarja konstatoi se komisioni me 6 vota “për” dhe dy “kundër” nxori këtë:

R E K O M A N D I M

1. Propozim-vendimi nr. 20/2017, datë 10 mars 2017, i Institucionit të Avokatit të Popullit për kandidatët e propozuar për zgjedhjen e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit, t'i kthehet Institucionit të Avokatit të Popullit.
2. Propozimi për kandidatët për zëvendës të Avokatit të Popullit, të bëhet, në përputhje me nenin 10, paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, dhe në përputhje me nenin 8, paragrafi 3 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit.

A R S Y E T I M

Institucioni i Avokatit të Popullit ka propozuar kandidatët për zgjedhjen e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit, dhe sipas Propozim-vendimit nr. 20/201, datë 10 mars 2017, nuk është plotësuar kriteri i propozimit të së paku dy kandidatëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ky Propozim-vendim duhet të jetë në pajtim me nenin 10, paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ku thuhet: *“Avokati i Popullit për zgjedhjen e 1 (një) zëvendësi, i propozon Kuvendit së paku 2 (dy) kandidatë”*.

Gjithashtu, në nenin 8, paragrafi 3 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit, thuhet: *“Për 1 (një) pozitë, zëvendës i Avokatit të Popullit, nga radhët e komuniteteve jo shumicë, dhe për 1 (një) pozitë zëvendës i Avokatit të Popullit, nga radhët e gjinisë tjetër nga ajo e Avokatit të Popullit, votimi bëhet i ndarë, sipas propozimit të Avokatit të Popullit”*.

2. Shqyrtimi i Peticioneve

Kryetarja tha se kemi kërkesën një qytetari nga Ferizaj, z. Ismet Sojeva, lënda e tij ka të bëjë me kërkesë për vlerësimin e ligjshmërisë për pranimin teknik të një objekti banesorë. Ajo tha se parashtruesi i kërkesës konsideron se pranimi i atij objekti është bërë në mënyrë jo të drejtë.

Pasi nuk pati diskutime lidhur me këtë çështje, nga anëtarët e Komisionit, kryetarja konstatoi se si Komision duhet t'i drejtohem organëve gjegjëse të Komunës së Ferizajt për sqarime lidhur me këtë rast.

Lirije Kajtazi tha se kërkesa e dytë është nga një qytetar i Prishtinës, lënda ka të bëjë me uzurpimin e pronës. Ajo tha se nuk ka arritur ta analizojë paraprakisht këtë lëndë.

Nëse dikush nga komisioni ka arritur që ta trajtojë paraprakisht këtë lëndë, atëherë mundet të na e prezantojë para Komisionit.

Pasi nga anëtarët e Komisionit nuk pati sqarime rreth trajtimit paraprak të kësaj lënde, atëherë kryetarja konstatoi se këtë petition po e shtyjmë për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Komisionit.

3. Të ndryshme

Teuta Haxhiu tha se është një rast i një të burgosuri, Burim Ramadani, në Qendrën Korrektuese në Dubravë, dhe është kërkesë urgjente për shkak të shkaqeve shëndetësore. Ajo tha se me një vendim të ministres së Drejtësisë, pezullohet vendimi për t'u trajtuar jashtë qendrave korrektuese.

Ajo propozoi që Komisioni Funkcional shumë shpejt të ketë një vizitë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, për ta parë situatën prej së afërmi, jo vetëm për këtë rast, por edhe rastet e tjera.

Nëse gjendja është jo e mirë, atëherë duhet të i drejtohem organeve kompetente ose për përmirësim të kushteve, apo edhe që të ju lejohet trajtimit jashtë institucionit të qendrave korrektuese.

Mexhide Mjaku-Topalli ngriti çështjen e vizitës nga ana e Komisionit Funkcional edhe në Qendrën Korrektues në Lipjan.

Pas diskutimeve lidhur me datën e vizitës në dy qendrat korrektuese të lartpërmendura, kryetarja konstatoi se Komisioni vendosi që këto vizita të bëhen më 4 prill 2017.

Mexhide Mjaku-Topalli ngriti çështjen e draft-udhëzuesit për peticione, duke theksuar se edhe pse si Komision e kemi dërguar emrin e përfaqësuesit të Komisionit Funkcional, në Komisionin për Legjislacion, prapëseprapë, në grupin punues për Draft-rregulloren e re të Kuvendit, nuk jam ftuar asnjëherë deri më tani dhe të jap kontributin tim për pjesën e shqyrtimit të peticioneve.

Teuta Haxhiu tha se e njëjta gjë është edhe lidhur me raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Komisioni për Legjislacion ka punuar në këtë drejtim dhe nuk jam ftuar të marrim pjesë në cilësinë e anëtares nga Komisioni Funkcional.

Ajo tha se duhet të ju shkruajmë përsëri dhe me i vënë në dijeni që kemi qenë të caktuara nëpër grupe punuese, dhe të njoftohemi.

Kryetarja kërkoi të bëhet një shkresë për Komisionin për Legjislacion dhe të kërkohen sqarime pse nuk janë ftuar anëtarët e komisionit tonë që janë të caktuar, dhe për takimin e radhës të njoftohemi.

Kryetarja i njoftoi lidhur me grupin punues që ka formuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, për shqyrtimin e amendamenteve në Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës. Ajo tha se është ftuar së bashku me deputeten zonja Mexhide Mjaku-Topalli, të cilat do të marrin pjesë në atë grup punues.

Gjithashtu, kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit se ajo dhe deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, sot, më 27 mars 2017, do të kenë një takim me përfaqësuesit e Organizatës “Save the Children” në Kosovë, ku mes tjerash do të diskutojmë për vizitën e përfaqësuesve të Organizatës “Save the Children” nga Suedia, në Komisionin Funksional, më 5 prill 2017.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI